



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.06.2025
Numër Protokolli: 4241/2025

A.nr.1129/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli-, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1129/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.O, kundër organit të punësimit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1129/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.O.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, Sh.O (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), përmes poste ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është pranuar me datë 12.06.2025 dhe numër protokolli 3963/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1129/2025, kundër Njoftimit të datës 16.05.2025 për rezultatet përfundimtare, të konkursit me Referencë RN00016806 të datës 21.02.2024 për Grupi Ligjor, për pozitën ‘Zyrtar i Lartë Ligjor’ të Shpallur nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr.1129/2025 të datës 12.06.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftim të datës 18.04.2025; Konkursit të datës 21.02.2025; Njoftimit të datës 16.05.2025 për rezultatet përfundimtare; Parashtresën e ankuesit të datës 18.06.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 21.02.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016806, për Grupi Ligjor, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Ligjor”-Profesional 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.02.2025 deri më 23.03.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit sipas Njoftimit të datës 18.04.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk e plotëson kriterin e punës ndërlidhur me përvojën e punës profesionale në fushën e kërkuar sipas kërkesave në konkursin e datës 21.02.2024, ndërsa sipas shkresave të lëndës arrihet në konstatimin se konkursi në fjalë ka përfunduar me datë 16.05.2025 sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 12.06.2025. Ankuesi, me datë 18.06.2026 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka përcjellë parashtrësë juridike, përmes së cilës deklarohet se i njëjti është tërhequr nga ankesa e tij e parashtruar përmes postës me datë 09.06.2025 kundër numër Reference RN00016806, për Grupi Ligjor, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Ligjor” të shpallur nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se nuk ka interes juridik të qëndrojë prapa pretendimeve të tij ankimore dhe ankesës së parashtruar, ndërsa parashtrësja e të njëjtit e datës 18.06.2025 në Këshill është protokolluar me numër:4132/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë” dhe erdhi në përfundimin se ankuesi përmes parashtrësës së datës 18.06.2025 me numër protokolli:4132/2025 është tërhequr nga ankesa e tij e datës 12.06.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1129/2025 të datës 12.06.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1129/2025

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Sh.O;
- Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.